



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE**  
**DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË**

**PROGRAMI I LËNDËS BIO 160**

<b>LËNDA:</b>	Botanika e përgjithshme
<b>Titullari/ Pedagogu i lëndës:</b>	MSc. Ilva Alushi
<b>Ngarkesa:</b>	3 lex / 1 sem / 1 lab
<b>Tipologjia e lëndës:</b>	Të formimit karakterizues të programit
<b>Viti akademik/ semestri kur zhvillohet:</b>	2019-2020/Pranvere 2020
<b>Lloji i lëndës:</b>	E Detyrueshme
<b>Programi i studimit:</b>	Bachelor në Biologji
<b>Kredite:</b>	8 Kredite
<b>Kodi i lëndës:</b>	BIO 160
<b>Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut:</b>	<a href="mailto:ilva.alushi@yahoo.com">ilva.alushi@yahoo.com</a> , <a href="mailto:ilva.alushi@univlora.edu.al">ilva.alushi@univlora.edu.al</a>

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

**Objektivat e lëndës:**

Lënda e Botanikës së Përgjithshme jep një formim të fushës studimore të Botanikës. Temat që do të trajtohen kanë të bëjnë me bimën, jetën, përbërjen kimike të bimës, qelizat eukariote dhe ato prokariote, organelat e qelizës bimore, indet bimore përbërja e tyre dhe funksioni, riprodhimi bimor, anatominë dhe morfologjinë e organelave riprodhuese tek bima.

**KONCEPTET THEMELORE:**

- 1 Indet bimore
- 2 Riprodhimi bimor
- 3 Organografia bimore

**TEMAT E LËNDËS QË DO TË TRAJTOHEN NË LEKSIONE:**

- Tema 1** Hyrje në botanikë. Rëndësia e bimëve në natyrë. Përbërja kimike e bimëve. Qeliza eukariote bimore.
- Tema 2** Citoplazma dhe bërthama. Organelet qelizore. Fotosinteza. Qelizat e kërpuhave. Qeliza prokariote, arket, viruset dhe prionet. Ndërtimi dhe fotosinteza tek qeliza prokariote
- Tema 3** Bërthama. Mejoza, mitoza dhe fekondimi. Plastet. Funksioni i kloroplasteve - fotosinteza. Plastet e tjera të bimëve. Amidoni dhe lëndë të tjera rezervë.
- Tema 4** Vakuola- lëngu qelizor. Muri dhe membrana qelizore. Muri qelizor parësor dhe plazmodezmat. Meatet dhe lakunat. Muri qelizor dytësor.
- Tema 5** Hyrje në Histologjinë bimore. Indet bimore meristemmatike, parësore dhe dytësore. Indet e rritur - Parenkimat. Indet e mbulimit.
- Tema 6** Indet mbështetëse-Kolenkima dhe sklerenkima. Indet përçuese-floema dhe ksilema dhe tufat përçuese. Indet pronditëse.

- Tema 7** Organizimi morfologjik i bimëve. Evolucioni morfologjik i bimëve. Rritja dhe Ndërtimi i parë anatomik i rrënjës. Ndërtimi i dytë anatomik tek rrënja. Morfologjia e kërcellit. Llojet e sythave. Degëzimi i kërcellitdiferencimi bimor. Sistemi rrënjor tek bimët.
- Tema 8** Ndërtimi i parë anatomik i rrënjës. Ndërtimi i dytë anatomik tek rrënja. Morfologjia e kërcellit. Llojet e sythave. Degëzimi i kërcellit.
- Tema 9** Ndërtimi i parë anatomik i kërcellit tek gjimnospermet, dikotiledonet dhe monokotiledonet. Ndërtimi i dytë anatomik i kërcellit tek drurët. Sistemet e tufave përcuese tek drurët. Formacionet e dyta në kërcellin e monokoteve. Morfologjia e gjethes.
- Tema 10** Gjethet e thjeshta dhe të përbëra. Anatomia e gjethes dhe diferencimi i saj. Ndërtimi anatomik i bishtit dhe i llapës gjethore tek angjospermët. Përshtatja e bimëve ndaj stresit ujqor, barëngrënësve dhe sëmundjeve, ndaj temperaturës, ndriçimit dhe hapësirës, ndaj mënyrës ushqyese.
- Tema 11** Riprodhimi seksual dhe aseksual. Ciklet jetësore tek bimët dhe këmbimi i brezave. Riprodhimi seksual dhe cikli jetësor i bimëve me lule. Rrethlulja: kupa dhe kurora. Ndërtimi i androceut dhe i kokrrizës së pjalmimit
- Tema 12** Ndërtimi i gineceut dhe ovulit. Mikrogametogjeneza. Megagametogjeneza. Pjalmimi, pllenimi ose fekondimi. Embrioni dhe zhvillimi i farës.
- Tema 13** Zhvillimi, shpërndarja dhe klasifikimi i fryteve. Mbirja e farave, faza vegetative dhe totipotenca. Faza riprodhuese. Plakja dhe seneshenca.

#### Temat që do trajtohen në seminare:

- Tema 1** Hyrje në botanikë, përbërja kimike e bimës dhe qeliza eukariote bimore.
- Tema 2** Ndërtimi i qelizave eukariote dhe prokariote
- Tema 3** Bërthama dhe plastet.
- Tema 4** Vakuola, muri qelizor parësor dhe dytësor
- Tema 5** Indi bimor meristematik, ind bimor parenkimor dhe i mbulimit.
- Tema 6** Indet mbështetës , përcues dhe të pronditjes.
- Tema 7** Organizimi morfologjik tek bimët. Njohuri mbi rritjen dhe diferencimin bimor. Rrënja –forma dhe funksioni
- Tema 8** Anatomia e rrënjës,ndërtimi i parë dhe i dytë anatomik. Morfologjia e kërcellit
- Tema 9** Ndërtimi i parë dhe i dytë anatomik tek kërcelli. Ndërtimi i dytë anatomik tek drurët. Morfologjia e gjethes
- Tema 10** Morfologjia e gjethëve të thjeshta dhe të përbëra. Anatomia e gjethes, diferencimi i saj. Ndërtimi anatomik tek bishti i gjethes dhe tek angjospermët.
- Tema 11** Anatomia e gjethes tek gjimnospermët dhe rënia e saj. Përshtatja e bimëve ndaj faktorëve stresantë.
- Tema 12** Ndërtimi i androceut, gineceut dhe i ovulit. Lulesa, pjalmimi, pllenimi dhe fekondimi
- Tema 13** Embrioni dhe zhvillimi i farës. Zhvillimi, shpërndarja dhe klasifikimi i fryteve. Cikli jetësor i bimëve dhe bioteknologjia bimore

#### Temat që do trajtohen në detyrimet e tjera të lidhura me lëndën: punë laboratorike, praktika, detyra

##### kursi eti:

- Tema 1** Ndërtimi i mikroskopit, përdorimi i tij dhe mjetet e punës gjatë orëve laboratorike.
- Tema 2** Teknika e prerjeve dhe ngjyimit, Pergatitja e preparateve dhe vizatimi
- Tema 3** Ndërtimi i përgjithshëm i qelizës tek bulbi i qepës (Allium cepa). Plastet, kloroplastet tek fieri. (Polypodium vulgare).Kromoplastet tek fryti i domates (Lycopersicum esculentum). Leukoplastet në rizomën e luleshpatores (Iris germanica).
- Tema 4** Berthama dhe kromozomet tek rrenja e qepës (Allium cepa) dhe tek pjalmi. Vakuola tek bima e grurit (Triticum vulgare) dhe tek bima e fikut (Ficus carica).
- Tema 5** Kokra të aleuronës tek fara e bimës së ricinit (Ricinus communis). Inulina tek zhardhoku i dahlias (Dahlia variabilis).
- Tema 6** Hesperdina në lëkurën e portokallit (Citrus aurantium). Taninet në faqen e poshtme të gjethes së fierit të zakonshëm (Polypodium vulgare). Kristalet në formë kubi tek cipa e qepës (Allium cepa).

**Tema 7** Druzë në bishtin e gjetes së begonjës (*Begonia rex*). Rafide në tulin e gjetes së aloes (*Aloe arborescens*). Stiloidet në tulin e gjetes së tradeskantias. Cistolitët në epidermën e gjetes së fikut (*Ficus elastica*).

**Tema 8** Poret e thjeshta në qelizat e paretit të kërcellit të kulprës (*Clematis vitalba*). Poret tek pisha (*Pinus sp.*).

**Tema 9** Indet meristematike dhe mbrojtëse. Meristema parësore tek rrenja e misrit (*Zea mays*). Epiderma dhe gojëzat tek luleshpatorja (*Iris germanica*). Epiderma dhe gojëzat tek lulja e fierit (*Polypodium vulgare*). Qimet tek blini (*Tilia sp.*), terfili (*Trifolium pratense*) dhe ulliri (*Olea europea*).

**Tema 10** Indet mbështetëse, parenkimor dhe pronditës.. Kolenkima dhe sklerenkima tek kungulli (*Cucurbita pepo*) dhe sklereidet tek dardha (*Pyrus communis*). Indet tek bima e kungullit (*Cucurbita pepo*). Xhepat lizogjenë tek portokalli (*Citrus aurantium*). Kanalet sekretore tek bishti gjethor i urthit (*Hedera helix*). Enët qumështore në kërcellin e euforbias (*Euphorbia sp.*).

**Tema 11** Ndërtimi i parë anatomik tek kërcelli i hithërbutës (*Lamium maculatum*) dhe misrit (*Zea mays*). Ndërtimi i dytë anatomik tek kërcelli i blinit (*Tilia cordata*) dhe pishës (*Pinus silvestris*).

**Tema 12** Ndërtimi i parë anatomik tek rrënja e luleshpatorës (*Iris germanica*). Ndërtimi i dytë anatomik tek rizokarpit tek bima e karotës (*Daucus carota*) dhe e repës (*Raphanus sativus*). Morfologjia e gjetes dhe e lllapës së gjetes. Anatomia e gjetes në bimën e ligustrumit (*Ligustrum lucidum*) dhe luleshpatorës (*Iris germanica*).

**Tema 13** Ndërtimi anatomik i pjalmores dhe i vezores tek lulja e zambakut (*Lilium candidum*). Analiza e lules. Diagrami dhe formula e lules. Morfologjia e lules. Ndërtimi dhe morfologjia e frytit. Ndërtimi i farës dhe i bimës tek bima e fasules (*Phaseolus vulgaris*), bima e ricinit (*Ricinus communis*), bimen e grurit (*Triticum vulgare*) dhe himën e nortokallit (*Citrus aurantium*).

**Tema 14** Praktike mësimore në terren.

#### **Temat e praktikave mësimore**

Njohjen e larmisë floristike (bimësia *Gymnospermae* dhe *Angiospermae*).

Vëzhgim i habitateve jetësore.

Vizite në Kopshtin Botanik Tiranë si një laborator “natyror”

Klasifikimi dhe përcaktimi i specieve bimore të mbledhura me anë të çelsave të përcaktimit.

Njohja me tekniken e herbarizimit të bimëve dhe ndërtimi i një herbari.

*Përcaktimi i itinerarit të lëvizjes do të bëhet në varësi të transportit në: Nartë, Orikum, Llogara, Tiranë, Sarandë.*

### **FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE**

<b>Kontrolli</b>	<b>Vlerësimi në përqindje</b>
Kontrolli I	20%
Vlerësimi vjetor: Seminare, laboratore dhe	20% (10% /5% /5%)
Kontrolli final	60%

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 41-100%.

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Vlerësimi	-40	41-50	51-60	61-70	71-80	81-90	91-100

#### **FREKUENTIMI:**

Studenti, që rezulton më pak se 75% frekuentim për periudhën që i përket cdo provimi të pjesshëm, periudhë për të cilën do të testohet, nuk do të futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.

Nëse studentit ka frekuentuar kursin, por nuk paraitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

#### **FORMATI I LËNDËS:**

Lënda do të vlerësohet mbi bazën e dy provimeve të pjesëshme, detyrave si dhe provimi final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do të ripërsëriten provimet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa ndonjë arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

**KOMUNIKIMI:**

Ushtrimet e detyrave të shtëpisë, detyra e kursit dhe çdo njoftim tjetër do të jepet në klasë ose në adresën zyrtare të Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës në internet: [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al) apo në adresën elektronike të pedagogut [ilva.alushi@yahoo.com](mailto:ilva.alushi@yahoo.com), [ilva.alushi@univlora.edu.al](mailto:ilva.alushi@univlora.edu.al)

**Email:** Çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Do të ketë detyra dhe njoftime do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

**KODI I NDERSHMËRISË:**

Studentët inkurajohen të punojnë edhe në grupe për ushtrimet e detyrat që u jepen. Nuk lejohen kopjimet nga njeri-tjetri në provime, për detyrat e kursit, të shtëpisë, etj. Thyerja e këtij rregulli do të shoqërohet me masa ndëshkimore që shkojnë deri në përjashtimin e studentit nga universiteti

**LITERATURA**

**a) Literatura bazë e detyrueshme:**

Botanikë e përgjithshme: A. Miho; L. Topuzi; J. Marka 2008 Ribotim: 2011. Praktikum i botanikës

**b) Literatura e rekomanduar:**

Raven H.P., Evert F.R., Eichhorn E.S., (2008) Biologjia e Bimëve. Përkthyer nga origjinali i vitit 1999 nga Kullaj E., Universiteti UFO. Tiranë 1-780

**VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS**

Ushtrimet e detyrave të shtëpisë, detyra e kursit dhe çdo njoftim tjetër do të jepet në klasë.

Studentët inkurajohen të punojnë edhe në grupe për ushtrimet e detyrave. Nuk lejohen kopjimet nga njëri-tjetri në provime, për detyrat e kursit, të shtëpisë, etj. Thyerja e këtij rregulli do të shoqërohet me masa ndëshkimore që shkojnë deri në përjashtim nga universiteti.

Nuk lejohet përdorimi i telefonave celulare dhe pirja e duhanit në auditor.

**PEDAGOGU I LËNDËS**

**MSc. Ilva Alushi**

.....







